

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI: SHËRBIM ISDN DHE INTERNET PËR QKUM

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 32412110-8

Fondi limit: 1,740,000 (Një milion e shtatëqind e dyzet mijë) lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim të Përgjithshëm të Lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e paraqitjes së ofertës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Ky kriter është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit përfshin ofrimin e shërbimit të internetit dhe E1 PRI ISDN, pra shërbime publike të komunikimeve elektronike, të cilat mund të ushtrohen vetëm nga operatorë të autorizuar ligjërisht. Kërkesa

garanton që operatori ekonomik ushtron aktivitetin në mënyrë të ligjshme, është i regjistruar pranë autoritetit rregullator dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes së tij. Ky kriter përbën kërkesë minimale ligjore dhe është proporcionale me natyrën e shërbimit objekt prokurimi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme justifikohet nga nevoja për të siguruar Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë kapacitetet teknike dhe përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Kjo vlerë përbën një element sigurie që garanton zbatimin me sukses të kontratës, në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë dhe respektimin e plotë të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, jo më pak se 3 (tre) specialistë të diplomuar në fushat e Telekomunikacionit, Elektronikës, Informatikës, Teknologjisë së Informacionit dhe/ose Inxhinierisë Elektrike.

Për këta punonjës, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse;
- kontratë pune të vlefshme;
- CV;

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Në këtë kuadër, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë staf të kualifikuar dhe personel teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës, në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Objekti i prokurimit përfshin instalimin, konfigurimin, operimin dhe mirëmbajtjen e shërbimit të internetit dhe E1 PRI ISDN, si dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit sipas kërkesave teknike të përcaktuara në DST. Numri minimal prej 3 specialistësh është përcaktuar në mënyrë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimit dhe synon të garantojë kapacitet teknik të mjaftueshëm për realizimin dhe mirëmbajtjen e kontratës dhe mbulim operacional.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skemën e përgjithshme të rrjetit të tij sipas elementëve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6 e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ky kriter është vendosur për të verifikuar kapacitetin teknik të operatorit ekonomik në funksion të realizimit të shërbimit objekt prokurimi.

Ky kriter është hartuar në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon infrastrukturën e nevojshme të rrjetit për garantimin e vazhdimësisë dhe stabilitetit të shërbimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skemën e lidhjes fizike (topologjinë) nga vendndodhja e QKUM deri në Pikën e Prezencës (POP) të operatorit, sipas elementëve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi: Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6 e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ky kriter është vendosur për të verifikuar mënyrën e realizimit të lidhjes fizike të shërbimit nga vendndodhja e QKUM deri në Pikën e Prezencës (POP) të operatorit.

Ky kriter është hartuar në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe synon të sigurojë përputhshmërinë e zgjidhjes së propozuar me kërkesat e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH ISO/IEC 27001 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standardi ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” është i nevojshëm, pasi garanton që operatori ekonomik zbaton procese të strukturuar dhe të standardizuara për ofrimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin ofrimin e shërbimit të internetit dhe E1 PRI ISDN, me kërkesa për vazhdimësi, disponueshmëri dhe ndërhyrje në kohë në rast defektesh, implementimi i ISO 9001 siguron që operatori ekonomik ka procedura të dokumentuara për menaxhimin e incidenteve, monitorimin e performancës dhe përmbushjen e kërkesave të cilësisë së shërbimit.

S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme; është i nevojshëm pasi objekti i prokurimit përfshin ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe trajtimin e infrastrukturës së rrjetit dhe të komunikimeve të një institucioni me funksion kritik. Ky standard garanton që operatori ekonomik zbaton politika dhe kontrole të dokumentuara për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit, mbrojtjen e të dhënave, ruajtjen e integritetit dhe disponueshmërisë së shërbimit, si dhe menaxhimin e incidenteve të sigurisë.

Kërkesa për këto standarde është në funksion të garantimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimit të ofruar, është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe synon të sigurojë autoritetin kontraktor se operatori ekonomik disponon procese të kontrolluara dhe të dokumentuara për realizimin e kontratës.

2.3.6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e të gjitha specifikimeve teknike të përcaktuara në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, kjo deklaratë është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik konfirmon përmbushjen e kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Paraqitja e kësaj deklarate shërben si garanci paraprake nga operatori ekonomik se shërbimi i ofruar do të realizohet në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe me natyrën e shërbimit objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e referencës dhe përlogaritja e fondit limit janë përgatitur/hartuar/përcjellë nga Autoriteti Kontraktor **“Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore”**, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/termat e referencës janë pjesë e pandashme e DST.